

## QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të Programit të aktiviteteve nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2024 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 12/24), dhe në lidhje me nenin 4 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave nr. 08-10226/1 të datës 17.09.2024, Qyteti i Shkupit shpall

### THIRRJE PUBLIKE për subvencionimin e qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e biçikletave në vitin 2024

#### 1. Qëllimi i Thirrjes publike

1.1. Lëndë e Thirrjes publike është ndarja e mjeteve financiare për qytetarët në territorin e qytetit të Shkupit, të dedikuara për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të bëra për blerjen e biçikletave për vitin 2024.

1.2. Mjetet që do të subvencionojë Qyteti i Shkupit janë në vlerën maksimale prej 4.000,00 denarësh për person, përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale.

1.3 Mjetet nga nënpika 1.2. janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2024 në Programin R1 Nënprogrami 464 Nënzëri 464990, në vlerë të përgjithshme prej 2.800.000,00 denarësh.

1.4. Thirrja publike do të zgjasë deri më 31.10.2024 ose deri në shterimin e mjeteve financiare të parashikuara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, në varësi të faktit se cili kusht paraqitet i pari.

1.5. Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë banorët e qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare), të cilët do të blejnë biçikletë të re në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga 01.01.2024 deri në shterimin e buxhetit të dedikuar për Thirrjen publike, por jo më vonë se 31.10.2024, dhe të cilët plotësojnë kushtet e kësaj Thirrjeje publike.

1.6. Aplikimet e arritura në Arkivin e Qytetit të Shkupit do të evidentohen me kohën e saktë të depozitimit (data, ora dhe minuta) dhe të njëjtat do të shqyrtohen sipas datës dhe kohës së mbërritjes.

#### 2. Kushte për pjesëmarrje në Thirrjen publike

Aplikanti duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë banor i qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Baba, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare),
- biçikleta e re të jetë blerë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 01.01.2024 deri në shterimin e mjeteve financiare të parashikuara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, por jo më vonë se 31.10.2024.

#### 3. Mënyra e aplikimit në Thirrjen publike

3.1. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe për të vërtetuar se janë plotësuar kushtet për pjesëmarrje në Thirrjen Publike, aplikanti është i obliguar të depozitojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- aplikim i plotësuar për subvencionim për blerjen e një biçiklete (aplikimi do të shpallet në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)).
- deklaratë e noterizuar se aplikanti pajtohet që të dhënat e tij personale të përdoren vetëm për pjesëmarrje në këtë Thirrje publike (një ekzemplar i deklaratës do të shpallet në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit : [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk) ).

- kopje e faqes së përparme të llogarisë së transaksionit (vetëm personale e aplikantit, jo e autorizuar nga një palë e tretë), ndërsa aplikantët që nuk kanë të ardhura të qëndrueshme të regjistruhen në Drejtorinë e të Ardhurave Publike duke hapur profilin e tyre të tatimit mbi të ardhurat personale.
- dëshmi se është blerë biçikletë e re, duke i bashkangjitur kuponin fiskal origjinal të lëshuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga data 01.01.2024, deri në shterimin e mjeteve financiare të parashikuara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, por jo më vonë se 31.10.2024, ku është e detyrueshme që biçikleta të jetë paguar plotësisht. Pagesa me këste nuk pranohet.

3.2. Një person mund të aplikojë vetëm një herë për të marrë subvencion për blerjen e një biçiklete.

3.3. Dokumentacionin e nevojshëm qytetarët e depozitojnë pranë Arkivit të Qytetit të Shkupit në zarf të mbyllur me shënimin: Sektori për mbrojtjen e mjedisit jetësor - Komisioni për subvencionimin e qytetarëve për blerjen e biçikletave në vitin 2024, çdo ditë pune nga e hëna në të premten, nga ora 08:30 deri në orën 15:00.

#### **4. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike**

4.1. Për përcaktimin e plotësimit të kushteve për ndarjen e mjeteve financiare, kryetarja e Qytetit të Shkupit formon Komisionin për subvencionimin e qytetarëve për blerjen e biçikletave në vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

4.2. Pagesa e mjeteve financiare do të bëhet në mënyrë sukcesive, sipas renditjes së aplikimeve të arritura, deri në shterimin e mjeteve financiare nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim.

4.3. Kur mjetet financiare të planifikuara të jenë shteruar, Qyteti i Shkupit do të shpallë përfundimin e Thirrjes publike.

4.4. Kryetarja e Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, do të sjellë Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare për aplikantët të cilët kanë plotësuar kushtet në bazë të pikës 2 të kësaj thirrjeje publike.

4.5. Në rast se kërkesa e paraqitur nuk miratohet për shkak të dokumentacionit jo të rregullt ose të paplotë, ose nëse aplikanti nuk plotëson kushtet nga pika 2 e kësaj thirrjeje publike, Komisioni do ta njoftojë aplikantin për arsyet pse nuk është miratuar.